

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 5 Aktive Afatgjatë të Mbajtura për t'u Shitur dhe Operacionet e Ndërprera

Janë shtuar aragrafët 8A, 36A dhe 44C.

Klasifikimi i aktiveve afatgjatë (ose grupeve për t'u nxjerrë jashtë përdorimit) si aktive afatgjatë të mbajtura për tu shitur.

8A Një njësi ekonomike që ka hartuar një plan shitje i cili do të sjellë humbjen e kontrollit mbi një filial të saj, duhet të klasifikojë të gjitha aktivet dhe detyrimet e këtij filiali si aktive të mbajtura për t'u shitur kur të gjitha kriteret e përcaktuara në paragrafët 6-8 janë plotësuar, pavarësisht faktit nëse njësi ekonomike do të ruajë një pjesë të investimit të saj (jo më kontrollues) në këtë ish-filial të saj mbas shitjes.

Paraqitja e operacioneve të ndërprera

36A Një njësi ekonomike që ka hartuar një plan shitje i cili do të sjellë humbjen e kontrollit mbi një filial të saj, duhet të japë në shënimet shpjeguese informacione ashtu sic kërkohet në paragrafët 33-36, kur ky filial është një grup i nxjerrë jashtë përdorimit që plotëson kriterin e një operacioni të ndërprerë në përputhje me paragrafin 32.

Data e hyrjes në fuqi

44C Paragrafët 8A dhe 36A janë shtuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojëzbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë datën 1 Korrik 2009 ose më pas. Megjithatë një njësi ekonomike nuk duhet të zbatojëzbatojë këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më herët se 1 Korrik 2009, përveç rastit kur ato zbatojnë SNK 27 (të rishikuar në Maj 2008). Nëse një njësi ekonomike i zbaton zbaton këto ndryshime më herët se 1 Korrik 2009, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese. Një njësi ekonomike duhet të zbatojëzbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive që nga dita që ajo aplikoi për herë të parë SNFR 5 duke marrë parasysh dhe kushtet e tranzicionit në paragrafin 45 të SNK 27 (i rishikuar në Maj 2008).

Shtojcë e Ndryshimeve të SNRF 5

Ndryshime të SNRF 1

Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë këto ndryshime të SNRF 1 kur ato zbatojnë ndryshimet respektive të SNRF 5.

SNRF 1 Zbatimi për herë të parë i Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

Është shtuar aragrafi 34C(c) është ndryshuar dhe paragrafi 47L.

Njohja dhe matja

Përfashtime për zbatimin retrospektiv të SNFR-ve të tjera

Investime që nuk kanë paketën kontrolluese

34C Një njësi ekonomike që zbaton SNRF-të për herë të parë, duhet të zbatojë në mënyrë retrospektive që nga data e kalimit në raportim sipas SNRF-ve, edhe kërkesat e mëposhtme të SNK 27 *Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale (siç janë rishikuar në vitin 2008)*.

(a) ...

(c) kërkesat në paragrafët 34-37 për mënyrën e kontabilizimit të humbjes së kontrollit mbi një filial, dhe kërkesat respektive të paragrafit 8A të SNRF 5.

...

Data e hyrjes në fuqi

47L Paragrafi 34C është ndryshuar me *Përmirësimet e SNRF-ve* të publikuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 Korrik 2009 ose më vonë. Në qoftë se një njësi ekonomike zbaton SNK 27 (i rishikuar në 2008) për një periudhë më të hershme, atëherë dhe këto ndryshime duhen zbatuar për këtë periudhë të hershme.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare (i rishikuar në 2007)*

Janë ndryshuar aragrafët 68 dhe 71. Eshtë shtuar ragrafi 139C.

Pasqyra e pozicionit financiar

Aktivitet afatshkurtëra

- 68 Cikli operativ i një njësie ekonomike është periudha që nga blerja e aktiveve për qëllime përpunimi deri në momentin e transformimit të tyre në mjete monetare ose ekuivalentë të mjeteve monetare. Kur cikli operativ normal i një njësie ekonomike nuk mund të identifikohet qartë, atëherë ai konsiderohet dymbëdhjetë muaj. Aktivitet afatshkurtër përmbledhin aktive (si psh inventaret, llogaritë e arkëtueshme tregtare) të cilat shiten, konsumohen ose realizohen si një proces normal i ciklit operativ edhe në rastin kur nuk pritet që ato të realizohen brenda dymbëdhjetë muajve pas periudhës raportuese. Aktivitet afatshkurtëra përfshijnë gjithashtu aktive të cilat janë destinuar kryesisht për t'u shitur (si psh aktive financiare të klasifikuara për t'u tregëtuar në përputhje me SNK 39) dhe pjesa afatshkurtër e aktiveve financiare afatgjatë.

Detyrimet afatshkurtëra

- 71 Detyrime të tjera afatshkurtër nuk shlyhen si një pjesë e ciklit normal operativ, por duhen shlyer brenda dymbëdhjetë muajve nga periudha raportuese ose mbahen si të destinuara kryesisht për t'u tregëtuar. Si shëmbuj mund të përmenden disa detyrime financiare të klasifikuara për tregëtim në përputhje me SNK 39, llogaritë bankare të zbuluara (overdraft), dhe pjesa afatshkurtër e detyrimeve financiare afatgjatë, dividendët për t'u paguar, detyrimet tatimore dhe llogari të tjera të pagueshme jo-tregëtare. Detyrimet financiare që përfaqësojnë financime mbi baza afatgjata (të cilat nuk janë pjesë e kapitalit punues që njësi ekonomike përdor në një cikël normal) dhe nuk janë për t'u shlyer brenda dymbëdhjetë muajve nga periudha raportuese, janë detyrime afatgjatë, dhe trajtohen në paragrafët 74 dhe 75.

Periudha tranzitore dhe data e hyrjes në fuqi

- 139C Paragrafët 68 dhe 71 janë ndryshuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Aplikime më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 *Aktivet Afatgjata Materiale*

Janë ndryshuar paragrafët 6 dhe 69.. Janë shtuar aragrafët 68A dhe 81D.

Përkufizime

- 6 Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard: :
- ...
- Shuma e rikuperueshme është më e madhja midis vlerës së drejtë të aktivit minus kostot e shitjes, dhe vlerës së tij të përdorimit.***
- ...

Mosnjohja

- 68A Sidoqoftë një njësi ekonomike që, në rrjedhën normale të aktivitetit, në mënyrë të përsëritur shet elementë të tillë të Aktiveve afatgjata materiale (si toka, ndërtesa, makineri e paisje) që i kishte mbajtur për t'i dhënë me qera tek të tjerët, duhet të transferojë këto aktive afatgjatë në grupin e inventareve me vlerën e mbartur kur ndërpritet dhënia e tyre me qetra dhe mbahen për t'u shitur. Të ardhurat nga shitja e këtyre aktiveve duhet të njihen si e ardhur në përputhje me SNK 18 *Të Ardhurat*. SNRF 5 nuk aplikohet kur aktivet që janë mbajtur për shitje në rrjedhën normale të biznesit transferohen në inventarë.
- 69 Nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivi afatgjatë material, mund të ndodhë në disa mënyra (psh duke i shitur, duke lidhur jëkontratë qeraje financiare ose duke i dhuruar. Për të përcaktuar datën e nxjerrjes jashtë përdorimit të një elementi të AAM njësi ekonomike zbaton kriteret e SNK 18 për njohjen e të ardhurave nga shitja e mallrave. SNK 17 aplikohet për nxjerrjen jashtë përdorimit me anën e shitjes dhe të rimarjes me qera.

Data e hyrjes në fuqi

- 81D Paragrafët 6 dhe 69 janë ndryshuar dhe paragrafi 68A është shtuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Aplikime më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese, dhe në të njëjtën kohë duhet të zbatojë ndryshimet përkatëse të SNK 7 *Pasqyra e Flukseve Monetare*.

Shtojcë e Ndryshimeve të SNK 16

Ndryshime të SNK 7

Njësitë ekonomike duhet të zbatojnë këto ndryshime të SNK 7 kur ato zbatojnë ndryshimet respektive të SNK 16.

SNK 7 Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë

Eshtë ndryshuar paragrafi 14. Eshtë shtuar ragrafi 55.

14 Flukset monetare

...

Disa lloje transaksionesh, si psh shitja e një elementi të një impianti, mund të çojnë në krijimin e një humbje apo fitimi i cili është përfshirë në përcaktimin e fitimi ose humbjes të njësisë ekonomike. Flukset monetare që rezultojnë nga këto transaksione janë flukse monetare nga aktivitetet investuese. Megjithatë, pagesat e kryera për të ndërtuar ose blerë aktive për t'u dhënë me qera tek të tjerë dhe më vonë të mbajtura për shitje siç janë përshkruar në paragrafin 68A të SNK 16 *Aktivitet Afatgjatë Materiale* janë flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit. Arkëtimet e mjeteve monetare të marra nga qeratat dhe nga shitja e mëvonshme e këtyre aktiveve, janë gjithashtu flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit

Data e hyrjes në fuqi

139C Paragrafi 14 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Aplikime më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese, dhe të zbatojë paragrafin 68A të SNK 16.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 19 *Përfitimet e Punonjësve*

Janë ndryshuar paragrafët 7, 8(b), 32B, 97, 98, 111, dhe 160. Janështuar aragrafët 111A dhe 159D.

Përkufizime

7

...

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve janë përfitime (përfshirë përfitimet që rrjedhin nga ndërprerja e marrëdhënies të punësimit) që duhen paguar brenda dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës që punonjësi ka qënë i punësuar.

...

Përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve janë përfitime (përfshirë përfitimet e pas-punësimit dhe përfitimet e ndërprerjes të marrëdhënies së punësimit që nuk duhen paguar brenda dymbëdhjetë muajve pas përfundimit të periudhës që punonjësi ka qënë i punësuar.

...

Kthimi mbi aktivet e skemës është interesi, dividendët dhe të ardhura të tjera të marra nga aktivet e skemës së bashku me përfitimet apo humbjet e realizuara apo të porealizuara ngakëto aktive të skemës, minus çdo kosto të administrimit të aktiveve të skemës (duke përfshirë ato që janë përfshirë në parashikimet aktuariale që përdoren për të matur detyrimin mbi përfitimet e përcaktuar) dhe minus tatimet që e pagueshme nga vetë skema.

...

Kosto e shërbimit të shkuar është ndryshimi në vlerën e aktualizuar i detyrimit për përfitimet e caktuara për shërbimin e punonjësve gjatë periudhave të kaluara që rezultojnë në periudhën aktuale si pasojë e futjes për herë të parë apo ndryshimeve të skemës së përfitimëve të pas-punësimit apo të përfitimëve të tjera afatgjatë. Kosto e shërbimit të shkuar mund të jetë pozitive (kur në momentin e futjes së skemës së përfitimëve apo ndryshimeve në të, detyrimi i përfitimëve të përcaktuara pëson rritje) ose negative (kur përfitimet aktuale ndryshojnë dhe si pasojë vlera aktuale e detyrimit të përfitimëve të përcaktuar ulet).

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve

8

Përfitimet afatshkurtëra të punonjësve përfshijnë zëra të tillë si:

- (b) kompensimi për mungesa afatshkurtëra në punë (si psh leja e zakonshme vjetore, mungesa për pa-afësi të përkohshme shëndetësore) kur kompensimi për mungesat duhet paguar brenda dymbëdhjetë muajve nga përfundimi i periudhës në të cilin punonjësi ka kryer shërbimin përkatës;

Përfitimet e pas-punësimit: dallimi midis skemave me përfitim të përcaktuar dhe skemave me kontribut të përcaktuar.

Skemat me disa punëdhënës

32B

SNK 37 *Provizionet, Pasivet e Kushtëzuara dhe Aktivet e Kushtëzuara* kërkon nga një njësi ekonomike që të paraqesë informacion në shënime shpjeguese për disa pasiveve të kushtëzuara. Në kushtet e një skeme me shumë punëdhënës një pasiv i kushtëzuar mund të lindë psh nga:

- (a) ...

Përfitimet e pas-punësimit: skemat me përfitim të përcaktuar

Kosto e shërbimit të shkuar

- 97 Kosto e shërbimit të shkuar lind kur një njësi ekonomike fut një skemë me përfitime të përcaktuara e cila u jep përfitime për shërbime të shkuara, ose ndryshon përfitimet e pagueshme për shërbimet e shkuara brenda një skeme eksistuese me përfitim të përcaktuar. Ndryshime të tilla bëhen në këmbim të shërbimit të punonjësve gjatë periudhës deri sa të jetë fituar e drejta për t'i marrë përfitimet në fjalë. Për rrjedhojë njësi ekonomike njehe kostot e shërbimeve të shkuara pavarësisht faktit që këto kosto ka të bëjë me shërbimin e punonjësve në periudhat e mëparshme.. Njësi ekonomike mat koston për shërbimin e shkuar si ndryshim në pasivet që lindin nga ndryshimet (Shih paragrafin 64). Kostot negative të shërbimit të shkuar ndodhin kur një njësi ekonomike ndryshon përfitimet që i përkasin shërbimit të shkuar në mënyrë të tillë që vlera e aktualizuar e detyrimit për përfitimet e përcaktuara bëhet më vogël.
- 98 Kostoja e shërbimit të shkuar përjashton:
- (a) (a) efektin e diferencave midis rritjeve faktike dhe rritjeve të supozuara të pagave dhe detyrimit për të paguar përfitime për shërbimin e kryer në vitet e mëparshme (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse hipotezat aktuariale mundësojnë parashikimin e pagave);
 - (b) (b) nënvlerësimet dhe mbivlerësimet e rritjeve të lira të pensioneve, kur një njësi ekonomike ka detyrimin konstruktiv për të bërë rritje të tilla (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse hipotezat aktuariale i lejojnë rritje të tilla);
 - (c) (c) çmuarjet e rritjes së përfitimeve, të cilat janë rezultat i fitimeve neto aktuariale që janë njohur në pasqyrat financiare kur njësi ekonomike është e detyruar, ose përmes kushteve formale të një skeme (ose përmes një detyrimi konstruktiv që shkon përtej këtyre kushteve) apo nga legjislacioni, që të përdorë suficitin e skemës në formë përfitimi për pjesëmarrësit e skemës, edhe sikur rritja e përfitimeve të mos jetë dhënë ende formalisht (rritja përkatëse e detyrimit është një humbje neto aktuariale dhe jo një kosto e shërbimit të shkuar, shih paragrafin 85(b));
 - (d) (d) rritjen e përfitimeve për të cilat është fituar e drejta kur, në mungesë të përfitimeve të reja ose të përmirësuar, punonjësit i përmbushin kërkesat e fitimit të së drejtës për t'i marrë përfitimet (nuk ka kosto të shërbimit të shkuar sepse kostoja e vlerësuar e përfitimeve është njohur më parë si kosto e shërbimit aktual në momentin kur është kryer shërbimi); dhe
 - (e) (e) efektin e ndryshimit të skemës, i cili i pakëson përfitimet për shërbimin e ardhshëm (ky është rasti i një reduktimi).

Reduktimi dhe shlyerjet

- 2 111 Një reduktim ndodh kur një njësi ekonomike:
- (a) demonstroi se është e angazhuar për të bërë një reduktim të konsiderueshëm të numrit të punonjësve të mbuluar nga skema; ose
 - (b) ndryshon kushtet e një skeme përfitimesh të përcaktuara në mënyrë të atillë, që një element material i shërbimit të ardhshëm të punonjësve ekzistues nuk kualifikohet më për përfitime, ose do të kualifikohet vetëm për përfitime të reduktuara.

Reduktimi mund të lindë nga një ngjarje e izoluar, siç është mbyllja e një linje prodhimi, ndërprerja e një operacioni ose pushimi apo pezullimi i një skeme. Një ngjarje është mjaftueshmërisht materiale për të plotësuar kushtet si një reduktim nëse njohja e një fitimi apo humbje neto nga reduktimi do të kishte një efekt material mbi pasqyrat financiare. Reduktimet lidhen shpesh me një ristrukturim. Për rrjedhojë, njësia ekonomike e kontabilizon reduktimin në të njëjtën kohë me ristrukturimin e lidhur me të.

- 111A Kur një ndryshim që i bëhet skemës sjell pakësimin e përfitimeve, vetëm pakësimi për shërbimet e ardhëshme quhet reduktim. Efeki i çdo reduktimi për shërbimet e shkuara është një kosto negative për periudhat e shkuara.

Data e hyrjes në fuqi

- 81D Paragrafët 7, 8(b), 32B, 97, 98 dhe 111 janë ndryshuar dhe paragrafi 111A është shtuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë ndryshimet në paragrafin 7, 8(b) dhe 32B për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Zbatime më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë ndryshimet në paragrafët 97, 98, 111, dhe 111A për ato ndryshime në përfitimet e punonjësve, që lindin në datën 1 Janar 2009 ose më pas.
- 160 SNK 8 zbatohet kur një njësi ekonomike ndryshon politikat e sajë kontabël për të reflektuar ndryshimet e specifikuar në paragrafët 159 – 159D. Duke zbatuar këto ndryshime në mënyrë retrospektive, siç e kërkon SNK 8, njësia ekonomike i trajton këto ndryshime sikur ato të kishin qënë zbatuar në të njëjtën kohë me pjesën tjetër të këtij Standarti. Përfundimi është që një njësi ekonomike mund të japë informacion shtesë për shumat siç kërkon paragrafi 120A(p) ku shumat përcaktohen për cdo periudhë raportuese që nga periudha e parë që paraqitet në pasqyrat financiare në të cilën njësia ekonomike për herë të parë zbaton ndryshimet në paragrafin 120A.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 20 *Kontabiliteti i Granteve dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhimën Qeveritare*

Është fshirë aragrafi 37. Janë shtuar paragrafët 10A dhe 43.

Grantet qeveritare

- 10A Përfitimi i një huaje qeveritare me interesa më të ulëta se interesat e tregut, trajtohet si një grant qeveritar. Huaja duhet njohur dhe matur në përputhje me SNK 39 *Instrumentat Financiarë. Njohja dhe Matja*. Përfitimi nga interesat më të ulëta se normat e interesit të tregut matet si diferencë midis vlerës kontabël neto fillestare të përcaktuar sipas SNK 39, dhe shumës së mjeteve monetare të marra. Përfitimi kontabilizohet në përputhje me këtë standart. Njësia ekonomike duhet të marrë në konsideratë kushtet dhe detyrimet që mund ose duhet plotësohen kur përcakton kostot të cilat do të synohen të kompensohen me përfitimin nga huaja.

Ndihmat qeveritare

- 37 [I fshirë]

Data e hyrjes në fuqi

- 43 Paragrafi 37 është fshirë dhe paragrafi 10A është shtuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime në mënyrë prospektive për huatë qeveritare të marra në periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Zbatimet më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 23 *Kostot e Huamarrjes* (rishikuar në 2007)

Eshtë ndryshuar paragrafi 6. Eshtë shtuar paragrafi 29A.

- 6 Kostot e huamarrjes mund të përfshijnë:
- (a) shpenzimet për interesa të llogaritura sipas metodës së interesit efektiv të përshkruar në SNK 39 *Instrumentat Financiare: Njohja dhe Matja*.
 - (b) [i fshirë]
 - (c) [i fshirë]
 - (d) shpenzimet financiare në lidhje me qeranë financiare të njohur në përputhje me SNK 17 *Qeratë*; dhe
 - (e) diferencat nga këmbimi që rrjedhin nga huamarrjet në monedhë të huaj deri në nivelin që ato gjykohen si një rregullim i kostove të interesave.

Data e hyrjes në fuqi

- 29A Paragrafi 6 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas. Zbatimet më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë ndryshim për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta sqaroj këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Ndryshime të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 27 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale (i ndryshuar në Janar 2008)

Eshtë ndryshuar paragrafi 38.

Kontabiliteti i investimeve në filiale, në njësi ekonomike të kontrolluara bashkërisht, dhe në pjesmarrje në pasqyrat financiare individuale

38 Kur një njësi ekonomike përgatit pasqyra financiare të individuale, ajo duhet të kontabilizojë investimet në filiale, në njësitë ekonomike me të kontrolluara bashkërisht, dhe në pjesmarrje:

(a) me metodën e kostos, ose

(b) në përputhje me SNK 39.

Njësia ekonomike duhet të zbatojë të njëjtën metodë kontabël për çdo kategori investimesh. Investimet që kontabilizohen me metodën e kostos duhet të kontabilizohen në përputhje me SNRF 5 *Aktivitet Afatgjatë të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera* kur ato janë klasifikuar si të mbajtura për t'u shitur (ose janë përfshirë në një grup të dalë jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për t'u shitur) në përputhje me SNRF 5. Matja e investimeve të kontabilizuara sipas SNK 39 nuk ndryshon në këto rrethana.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha tranzitore

45A Paragrafi 38 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve të SNRF-ve* të botuara në Maj 2008. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë në datën 1 Janar 2009 ose më pas në mënyrë prospektive që nga data kur IFRS 5 është zbatuar për herë të parë. Zbatimet më herët se kjo datë janë të lejuara. Nëse një njësi ekonomike zbaton këtë amendim për një periudhë me të hershme, ajo duhet ta sqarojë këtë fakt në shënimet shpjeguese.

Ndryshim i Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 28 *Investimet në Pjesëmarrje*

Paragrafët 1 dhe 33 dhe titulli mbi paragrafin 41 janë ndryshuar. Paragrafi 41C është shtuar i ri.

Objekti

1 Ky standard do të zbatohet për kontabilitetin e investimeve në pjesëmarrje. Gjithsesi, ai nuk zbatohet për investimet në pjesëmarrje të bëra nga:

- (a) organizatat me kapital sipërmarrës, ose
- (b) fonde të ndërsjellta, truste njësie dhe njësi të ngjashme ekonomike, duke përfshirë dhe fondet e sigurimeve të lidhura me investimet

që me njohjen fillestare përcaktohen në një vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe klasifikohen si të mbajtura për treg dhe llogariten në përputhje me SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*. Investime të tilla do të maten në vlerë të drejtë në përputhje me SNK 39, me ndryshimet në vlerën e drejtë të njohura në përfitim ose humbje në periudhën e ndryshimit. Një njësi ekonomike që ka një investim të tillë duhet të japë informacionet shpjeguese të kërkuara nga paragrafi 37(f).

Zbatimi i metodës së kapitalit neto

Humbjet nga çvlerësimi

33 Për shkak të faktit se emri i mirë që përfshihet në shumën e mbartur të një investimi në një pjesëmarrje nuk njihet veçmas, ai nuk testohet veçmas për çvlerësimin duke zbatuar kërkesat e çvlerësimit që teston emrin e mirë në SNK 36 *Çvlerësim i Aktiveve*. Por, e tërë shumën e mbartur e investimit testohet për çvlerësim në përputhje me SNK 36 si një aktiv i vetëm, duke krahasuar shumën e tij të rikuperueshme (më e lartë se vlera në përdorim dhe vlera e drejtë pa kostot e shitjes) me vlerën e tij të mbartur, në çdo rast kur zbatimi i kërkesave të SNK 39 tregon se investimi mund të çvlerësohet. Humbja nga çvlerësimi e njohur në rrethana të tilla nuk alokohet për asnjë aktiv, duke përfshirë dhe emrin e mirë, që është pjesë e shumës mbartëse të investimit në pjesëmarrje. Si rezultat, çdo tjetërsim i kësaj humbje nga çvlerësimi njihet në përputhje me SNK 36 deri në masën që si pasojë rritet shumën e rikuperueshme e investimit. Në përcaktimin e vlerës në përdorimin e investimit, një njësi ekonomike vlerëson:

- (a) ...

Data e Hyrjes në Fuqi dhe periudha kalimtare

41C Paragrafët 1 dhe 33 u ndryshuan me anë të *Përmirësimeve të SNK-ve* të dala në maj të vitit 2008. Një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2009. Lejohet dhe zbatim i mëparshëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimet në një periudhë më të hershme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë gjë dhe zbaton për këtë periudhë të hershme ndryshimet në paragrafin 3 të IFRS 7 *Instrumentet Financiare: Dhënia e Informacioneve shpjeguese*, paragrafi 1 i SNK 31 dhe paragrafi 4 i SNK 32 *Instrumentet Financiare: Prezantimet* e nxjerra në maj 2008. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimet më pas.

Ndryshim në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*

Paragrafi 1 dhe titulli mbi paragrafin 58 janë ndryshuar. Është shtuar paragrafi 58B.

Objekti

1 Ky paragraf do të zbatohet për trajtimin kontabël të interesave në sipërmarrjet e përbashkëta dhe raportimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve të sipërmarrjeve në pasqyrat financiare të sipërmarrësit dhe investitorëve, pavarësisht nga strukturat ose format sipas të cilave kryhen aktivitetet e sipërmarrjes. Megjithatë, nuk do të zbatohet në njësitë ekonomike të bashkëkontrolluara për interesat e sipërmarrësve, të mbajtura prej:

- (a) organizatave kapitale sipërmarrëse, ose
- (b) fondet e përbashkëta, njësitë e besimit dhe njësitë ekonomike të ngjashme përfshirë fondet e sigurimit të lidhura me investimin.

që në momentin e njohjes fillestare janë përcaktuar si me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes ose janë klasifikuar si të mbajtura për tregtim dhe kontabilizohen në përputhje me SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe matja*. Këto investime do të maten me vlerën e drejtë në përputhje me SNK 39, duke njohur ndryshimet në vlerën e drejtë në fitimi ose humbje në periudhën e ndodhjes së ndryshimit. Një sipërmarrës që ka një interes të tillë do të japë informacion shpjegues siç kërkohet nga paragrafet 55 dhe 56.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

58B Paragrafi 1 është ndryshuar sipas *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi edhe për një periudhë më të hershme. Në qoftë se një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe zbaton për këtë periudhë edhe ndryshimet në paragrafin 3 të SNRF 7 *Instrumentet financiare: Dhënia e informacioneve shpjeguese*, paragrafin 1 të SNK 28 dhe paragrafin 4 të SNK 32 *Instrumentet financiare: Paraqitja* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimin në *mënyrë prospektive*.

Shtojcë për ndryshimet në SNK 28 dhe SNK 31

Ndryshimet në SNRF-të e tjera

Njësitë ekonomike do të zbatojnë ndryshimet në SNRF 7 dhe SNK 32 në këtë shtojcë kur ato zbatojnë ndryshimet që kanë lidhje me SNK 28 dhe SNK 31.

SNRF 7 Instrumentet financiare: Dhënia e informacionit shpjegues

Paragrafi 3(a) është ndryshuar. Është shtuar paragrafi 44D.

Objekti

- 3 Ky SNRF do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e intrumenteve financiare, me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, sipërmarrje të përbashkëta ose pjesëmarrje që trajtohen në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*, SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje ose SNK 31 Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 lejojnë që një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNK 39; në këto raste, njësitë ekonomike do të zbatojnë kërkesat e këtij SNRF. Gjithashtu, njësitë ekonomike do të zbatojnë këtë SNRF për të gjithë derivativët që lidhen me interesat në filiale, pjesëmarrjet ose sipërmarrjet e përbashkëta me përjashtim të rastit kur derivativi plotëson përkufizimin e një instrumenti kapitali sipas SNK32.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 44D Paragrafi 3(a) është ndryshuar sipas *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Në qoftë se një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe zbaton për këtë periudhë më të hershme edhe ndryshimet në paragrafin 1 të SNK 28, paragrafin 1 të SNK 31 dhe paragrafin 4 të SNK 32 të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimin në mënyrë prospektive.

SNK 32 Instrumentet financiare: Paraqitja

Paragrafi 4(a) dhe titulli i paragrafit 96 janë ndryshuar. Është shtuar paragrafi 97D.

Objekti

- 4 Ky standard do të zbatohet nga të gjitha njësitë ekonomike për të gjitha llojet e instrumenteve financiare me përjashtim të:
- (a) atyre interesave në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrjet e përbashkëta që trajtohen në përputhje me SNK 27 *Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale*, SNK 28 *Investimet në pjesëmarrje ose* SNK 31 *Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta*. Megjithatë, në disa raste, SNK 27, SNK 28 ose SNK 31 lejojnë që një njësi ekonomike të kontabilizojë një interes në një filial, pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët duke përdorur SNK 39; në këto raste, njësitë ekonomike do të zbatojnë kërkesat e këtij Standardi. Gjithashtu, njësitë ekonomike do të zbatojnë këtë Standard për të gjithë derivativët që lidhen me interesat në filiale, pjesëmarrje ose sipërmarrjet e përbashkëta.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

- 97D Paragrafi 4(a) është ndryshuar sipas *Përmirësimeve në SNRF-të* të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2009 e në vijim. Lejohet zbatimi përpara kësaj date. Në qoftë se një njësi ekonomike e zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt dhe zbaton për këtë periudhë më të hershme edhe ndryshimet në paragrafin 3 të SNRF 7, paragrafin 1 të SNK 28 dhe paragrafin 1 të SNK 31 të publikuara në maj 2008. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimin në mënyrë prospektive.

Ndryshimet për Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 29 Raportimi Financiar në Ekonomitë me Hiperinflacion

Janë ndryshuar paragrafët 6, 15 dhe 19. Këto zbatime do të zbatohen për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose pas 1 janarit të vitit 2009. Lejohet zbatimi i mëparshëm.

Rideklarimi i pasqyrave financiare

- 6 Njësitë ekonomike që përgatisin pasqyra financiare mbi baza kostosh historike të kontabilitetit e bëjnë këtë gjë pa pasur parasysh ndryshimet në nivelin e përgjithshëm të çmimeve ose rritjet në çmime specifike të aktiveve ose pasiveve të njohura. Përjashtim bëjnë ato aktive apo pasive që njësisë ekonomike i kërkohet, ose përzgjedh të masë në vlerë të drejtë. Për shembull, toka, ndërtesa, makineri e pajisje mund të rivlerësohen me vlerën e drejtë dhe aktivet biologjike në përgjithësi kërkohet të maten me vlerën e drejtë. Gjithsesi, disa njësi ekonomike paraqesin pasqyra financiare që bazohen në një kosto aktuale që reflekton efektet e ndryshimeve në çmimet specifike të aktiveve përkatëse.
- 15 Pjesa më e madhe e artikujve jo-monetarë mbarten me kosto ose me koston minus amortizimin; pra ato vlerësohen në shuma që janë aktuale në datën e blerjes. Kostoja e rivlerësuar, ose kostoja minus amortizimin e secilit artikull përcaktohet duke aplikuar mbi koston historike dhe amortizimin e akumuluar ndryshimin e indeksit të përgjithshëm të çmimit të përgjithshëm nga data e blerjes deri në fund të periudhës së raportimit. Për shembull, toka, ndërtesa, makineri e pajisje, inventaret e materialeve të lëndëve të para dhe të tregtisë, emri i mirë, patentat, markat dhe aktive të ngjashme rivlerësohen nga data e blerjes së tyre. Inventaret e mallrave pjesërisht të përfunduara dhe të përfunduara riparaqiten nga datat e blerjes dhe të ruajtjes.
- 19 Shuma e riparaqitur e një artikulli jomonetar ulet, në përputhje me SNK-të përkatëse, kur kalon shuma e rikuperueshme. Për shembull, shumat e riparaqitura të tokës, ndërtesave, makinerive dhe pajisjeve, emri i mirë, patentat dhe markat ulen tek shuma e rikuperueshme dhe shumat e riparaqitura të inventarëve zbriten tek vlera neto e realizueshme.

Ndryshim i Standardit 36 Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Çvlerësim i Aktiveve*

Ndryshohet paragrafi 134(e). Shtohet paragrafi 140C.

Dhënia e Informacioneve Shpjeguese

Vlerësimet e përdorura për të matur shumat e permiresuara të njësive gjeneruese të mjeteve monetare që përmbajnë emrin e mirë ose aktive të jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar

134 Një njësi ekonomike jep informacionin shpjegues që kërkohet në pikat (a)–(f) për çdo njësi të gjenerueshme të mjeteve monetare (grup njësisish) për të cilat shuma e mbartur e emrit të mirë ose e aktiveve të jomateriale me jetë të dobishme të papërcaktuar:

(e) nëse shuma e permiresuar e njësisë (grupit të njësive) bazohet në paraqitjen me vleren e drejtë minus kostot e shitjes, metoda e përdorur është ajo e Vleres së drejtë minus koston e shitjes. Nëse paraqitja me vleren e drejtë minus koston e shitjes nuk përcaktohet duke përdorur një çmim të dukshëm tregu për njësinë (grup njësisish), do të jepet dhe informacioni i mëposhtëm shpjegues:

- (i) një përshkrim i çdo supozimi kryesor mbi të cilin njësia drejtuese ka përcaktuar paraqitjen me vleren e drejtë pa koston e shitjes. Supozimet kyçe janë ato supozime ndaj të cilave është më e ndjeshme shuma e permiresuar/rimëkëmbur e njësisë (grupit të njësive).
- (ii) një përshkrim i qasjes së njësisë drejtuese për të përcaktuar vlerën (ose vlerat) që i caktohen çdo supozimi kyç, pavarësisht nëse këto vlera reflektojnë eksperiencën të së shkuarës, ose, nëse është e nevojshme, nëse janë në përputhje me burimet e jashtme të informacionit, dhe, nëse jo, si dhe pse ndryshojnë ato nga eksperiencën në të shkuarën dhe burime të jashtme informacioni.

Nëse paraqitja me vleren e drejtë minus kostot e shitjes përcaktohet duke përdorur parashikime të scontimit(zbritjes) të fluksit të mjeteve monetare, duhet të bëhet i ditur dhe informacioni i mëposhtëm:

- (iii) periudha në të cilën njësia drejtuese ka projektuar fluksin e mjeteve monetare.
- (iv) nivelin e rritjes së përdorur për të bërë parashikime të flukseve të mjeteve monetare.
- (v) nivelin/nivelet e skontimit(zbritjes) të aplikuar për parashikimet e fluksit të mjeteve monetare.

Dispozita tranzitore dhe data e hyrjes në fuqi

140C Paragrafi 134(e) u ndryshua me anë të *përmirësimeve të SNK-ve* të nxjerra në maj të vitit 2008. Një njësi ekonomike e zbaton atë ndryshim për periudha një vjeçare duke filluar më 1 janar 2009 ose pas datës 1 janar 2009. Lejohet aplikimi i mëparshëm. Nëse ndonjë njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë të mëparshme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt.

Ndryshim i Standardit 38 Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Çvlerësim i Aktiveve Jomateriale*

Ndryshohen paragrafët 69, 70 dhe 98. Shtohen paragrafët 69A dhe 130D.

Njohja e një shpenzimi

- 69 Në disa raste shpenzimi bëhet për t'i krijuar përfitime ekonomike një njësie ekonomike në të ardhmen, por nuk njihet asnjë aktiv jomaterial ose një aktiv tjetër të blere ose krijuar. Në rastin e furnizimit me mallra, njësia ekonomike e njej një shpenzim të tillë si shpenzim kur ajo gëzon të drejtën e kontrollit të këtyre mallrave. Për shembull, shpenzimi për një kërkim njihet si shpenzim kur bëhet (shih paragrafin 54), në përjashtim të rasteve kur blihet si pjesë e një kombinimi biznesi. Të tjera shembuj shpenzimesh që njihen si shpenzime kur bëhen përfshijnë:
- (a) ...
 - (c) shpenzimet për reklama dhe aktivitete promovionale (duke përfshirë dhe katalogë të porositur me postë).
 - (d) ...
- 69A Një njësi ekonomike ka të drejtë të aksesojë mallra kur ajo i zotëron këto mallra. Në të njëjtën mënyrë, ajo ka të drejtë të aksesojë mallra kur ato janë ndërtuar nga një furnizues në përputhje me kushtet e një kontrate për t'ia furnizuar ato njësisë ekonomike dhe jo kur njësia ekonomike i përdor ato për të ofruar një shërbim tjetër, për shembull, për të bërë një reklamë për konsumatorët.
- 70 Paragrafi 68 nuk e parandalon një njësi ekonomike nga njohja e parapagesës si një aktiv, kur pagesa për mallra është bërë para se njësia ekonomike të merrte të drejtën e aksesit ndaj këtyre mallrave. Në të njëjtën mënyrë, paragrafi 68 nuk e parandalon një njësi ekonomike nga njohja e një parapagese si një aktiv ku pagesa për shërbimet është bërë në marrveshje me njësinë ekonomike që ka marrë këto shërbime.

Aktivitet jomateriale me jetë të dobishme të përcaktuara

Periudha dhe metoda e amortizimit

- 98 Mund të përdoren disa metoda amortizimi për të ndarë shumën e amortizimit të një aktivi mbi një bazë sistematike gjatë jetës së tij të dobishme. Këto metoda përfshijnë metodën lineare, metodën e zvogëlimit të tepricës dhe metodën e njësisë së prodhimit. Metoda e përdorur përzgjidhet mbi bazën e llojit të konsumimit të pritshëm të përfitimeve ekonomike të ardhme në aktiv dhe zbatohet në mënyrë konsistente nga njëra periudhë tek tjetra, në përjashtim të rasteve kur ka ndryshim në llojin e konsumit të pritur të këtyre përfitimeve ekonomike të ardhme.

Periudha tranzitore dhe hyrja në fuqi

- 130D U ndryshuan paragrafët 69, 70 dhe 9 dhe u shtua paragrafi 69A nëpërmjet *përmirësimeve të SNRK-ve* të dala në maj të 2008-ës. Një njësi ekonomike e zbaton atë ndryshim për periudha një vjeçare duke filluar më 1 janar 2009 ose pas datës 1 janar 2009. Lejohet aplikimi i mëparshëm. Nëse ndonjë njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë të mëparshme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt.

Ndryshim i Standardit 39 Ndërkombëtar të Kontabilitetit: *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*

Janë ndryshuar paragrafët 9, 73 dhe AG8. U shtuan paragrafët 50A dhe 108C.

Përkufizime

9 Termat e mëposhtëm jepen në Standard me kuptimet e specifikuara më poshtë:

...

Përkufizimet e katër kategorive të instrumenteve financiare

Një *aktiv apo pasiv financiar në paraqitjen me vlerën e drejtë përmes përfitimit ose humbjes* është një aktiv ose pasiv financiar që plotëson njërën nga kushtet e mëposhtme.

- (a) Ai klasifikohet si i mbajtur për shitje. Një aktiv ose pasiv financiar klasifikohet si i mbajtur për shitje nëse:
- (i) është blerë ose marrë kryesisht për qëllim të shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër;
 - (ii) në njohjen fillestare është pjesë e portofolit të instrumenteve financiare të identifikuara që menaxhohen së bashku dhe për të cilat ka prova të një skeme aktuale të nxjerrjes së përfitimit afatshkurtër; ose
 - (iii) është derivativ (në përjashtim të një derivative që është një kontratë garancie financiare ose është një instrument mbulues i përcaktuar ose efektiv).
- (b) ...

Masat

Riklasifikimet

50A Ndryshimet në rrethanat e mëposhtme nuk riklasifikohen për qëllimet e paragrafit 50:

- (a) një derivativ që më parë ishte përcaktuar si një instrument mbulues ose ishte një instrument mbulues efektiv në një mbulim të fluksit të mjeteve monetare ose në një mbulim investimesh neto nuk klasifikohet më si i tillë;
- (b) një derivativ bëhet një instrument mbulues i përcaktuar ose efektiv në një mbulim të fluksit të mjeteve monetare ose në një mbulim investimi neto;
- (c) aktivet financiare riklasifikohen kur një njesi sigurimesh ndryshon politikat e saj të kontabilitetit në përputhje me paragrafin 45 të SNRK 4.

Mbulimi

Instrumentet mbuluese

Instrumentet kualifikuese

73 Për qëllime të kontabilitetit mbrojtës, si instrumente mbuluese mund të përcaktohen vetëm ato instrumente që përfshijnë një palë të jashtme nga njësia ekonomike e raportimit (p.sh. e jashtme

për grupin ose njësinë ekonomike individuale që raportohet). Megjithëse njësitë ekonomike individuale brenda një grupi ose divizioneve të konsoliduara brenda një njësie ekonomike mund të hyjnë në transaksione mbuluese me njësi të tjera ekonomike brenda grupit ose divizioneve brenda njësisë ekonomike, çdo transaksion i tillë brenda grupit eliminohet me konsolidim. Pra, transaksione të tilla mbuluese nuk cilësohen për kontabilitetin mbulues të pasqyrave financiare individuale ose të veçanta të njësive ekonomike individuale brenda grupit, me kushtin që ato janë të jashtme nga njësia ekonomike individuale që raportohet.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha tranzitore

- 108C Janë ndryshuar paragrafët 9, 73 dhe AG8, dhe është shtuar paragrafi 50A me anë të *përmirësimeve të SNK-ve* të dala në maj të vitit 2008. Një njësi ekonomike do t'i zbatojë këto ndryshime dhe në paragrafët 9 dhe 50A në datën dhe në mënyrën e zbatimit të ndryshimeve të 2005-ës, të parashikuara në paragrafin 105A. Lejohet zbatimi i mëparshëm i të gjitha ndryshimeve. Nëse një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet për një periudhë të mëparshme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë gjë.

Ndryshim në udhëzimin e zbatimit të SNK 39 *Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja*

Përkufizime (paragrafët 8 dhe 9)

Norma efektive e interesit

AG8 Nëse një njësi ekonomike rishikon vlerësimet e saj të pagesave ose faturave, njësi ekonomike duhet të rregullojë shumën mbartëse të aktivitetit ose pasivitetit financiar (ose grupit të instrumenteve financiare) ose të reflektojë vlera të flukseve aktuale dhe të rishikuara të mjeteve financiare. Njësia ekonomike ri-përlllogarit shumën mbartëse duke llogaritur vlerën aktuale të fluksit të vlerësuar të mjeteve monetare të ardhshme në normën e interesit origjinale të instrumenteve financiare, ose, kur zbatohet, norma efektive e rishikuar e interesit e përlllogaritur në përputhje me paragrafin 92. Rregullimi njihet në fitim ose humbje si e ardhur ose shpenzim.

Ndryshime në Standardin 40 Ndërkombëtar të Kontabilitetit *Aktiv Afatgjatë Material i Investuar*

Janë ndryshuar paragrafët 8, 9, 48, 53, 54 dhe 57. Paragrafi 22 është fshirë dhe janë shtuar paragrafët 53A, 53B dhe 85B.

Përkufizime

- 8 Më poshtë janë dhënë raste të aktivitetit afatgjatë material të investuar:
- (a) ...
 - (e) pronë që po ndërtohet apo zhvillohet për përdorim në të ardhmen si një aktiv afatgjatë material të investuar.
- 9 shembujt e mëposhtëm janë element që nuk përbëjnë aktive afatgjatë material të investuar, dhe, si rezultat, janë jashtë objektit të këtij Standardi:
- (a) ...
 - (d) [fshirë]
 - (e) ...

Masat dhe njohja

- 22 [Fshirë]

Metoda e vlerës së drejtë

- 48 Në raste përjashtimore, ka prova të qarta se kur një njësi ekonomike ble së pari një aktiv afatgjatë material të investuar (ose ku një pronë ekzistuese bëhet fillimisht aktiv afatgjatë material i investuar pas një ndryshimi në përdorim) ndryshueshmëria e vlerës së drejtë të arsyeshme do të jetë kaq e madhe, dhe probabilitetet e rezultateve të ndryshme do të jenë kaq të vështira për t'u siguruar, saqë behet i padobishëm një vlerësim i vetëm i një vlere të drejtë. Kjo mund të dëshmojë se një vlerë e drejtë e aktivitetit nuk përcaktohet besueshëm mbi një bazë të vazhdueshme (shih paragrafin 53).

Paaftësia për të caktuar vlerën e drejtë në mënyrë të besueshme

- 53 Ka një hipotezë të kundërshtueshme sipas së cilës një njësi ekonomike mund të përcaktojë në mënyrë të besueshme vlerën e drejtë të aktivitetit afatgjatë material të investuar mbi një bazë të vazhdueshme. Gjithsesi, në raste përjashtimore, ka prova të qarta se kur njësi ekonomike ble së pari një aktiv afatgjatë material të investuar (ose kur një aktiv ekzistues bëhet aktiv afatgjatë material i investuar si rezultat i ndryshimit në përdorim) që vlera e drejtë e aktivitetit afatgjatë material të investuar nuk përcaktohet në mënyrë të besueshme mbi një bazë reale. Kjo ndodh kur, dhe vetëm kur, transaksionet e krahasueshme të tregut nuk bëhen rregullisht dhe nuk disponohen vlerësime alternative të vlerës së drejtë (p.sh. në bazë të parashikimeve të skontuara të flukseve të mjeteve monetare). Nëse një njësi ekonomike përcakton se vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë material të investuar që është në ndërtim nuk është i përcaktueshëm në mënyrë të besueshme, por pret që vlera e drejtë e aktivitetit të përcaktueshme në mënyrë të besueshme kur të përfundojë ndërtimi, ajo duhet të masë aktivin afatgjatë material të investuar që është në ndërtim me kosto ose kur vlera e drejtë të bëhet e besueshme ose kur të ketë përfunduar ndërtimi (cilado të ndodhë më parë). Nëse një njësi ekonomike përcakton se vlera e drejtë e një aktivi afatgjatë material të investuar (i ndryshëm nga një aktiv afatgjatë material i investuar në ndërtim) nuk është përcaktuar në mënyrë të besueshme mbi një bazë të vazhdueshme, njësi do të masë aktivin afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e koston në SNK 16. Vlera e tepriçës të aktivitetit

afatgjatë material të investuar do të supozohet të jetë zero. Njësia ekonomike zbaton SNK-në 16 deri në daljen jashtë përdorimi të aktivit afatgjatë material të investuar.

- 53A Në momentin kur një njësi ekonomike aftësohet në matjen e një vlere të drejtë të besueshme të një aktivit afatgjatë material të investuar në ndërtim që më parë është matur në kosto, ajo mat aktivin me vlerën e tij të drejtë. Kur të ketë përfunduar ndërtimi i kësaj prone, mendohet që vlera e drejtë të matet në mënyrë të besueshme. Nëse nuk ndodh kështu, në përputhje me paragrafin 53, aktivin do të vlerësohet duke përdorur modelin e koston, në përputhje me SNK 16.
- 53B Supozimi se vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar që është në ndërtim mund të matet në mënyrë të besueshme mund të kundërshtohet vetëm në njohjen fillestare. Një njësi ekonomike që ka matur një aktiv afatgjatë material të investuar që është në ndërtim mund të mos arrijë në përfundimin se vlera e drejtë e aktivit afatgjatë material të investuar të përfunduar nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme.
- 54 Në raste përjashtimore, kur një njësi ekonomike detyrohet të masë aktivin afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e koston në përputhje me SNK 16, për arsye të dhëna në paragrafin 53, ajo mat me vlerën e drejtë të gjithë aktivet e tjera afatgjata materiale të investuara, duke përfshirë dhe aktivet që janë në ndërtim. Në këto raste, megjithëse një njësi ekonomike mund të përdorë modelin e koston për një aktiv afatgjatë material të investuar, njësia ekonomike do të vazhdojë të marrë parasysh secilin nga aktivet e mbetura, duke përdorur modelin e vlerës së drejtë.

Transferimet

- 57 **Transferimet për në ose nga aktivin afatgjatë material të investuar do të bëhen vetëm, dhe vetëm kur ka një ndryshim në përdorim, i provuar nga:**
- (a) ...
 - (c) **përfundimi i përdorimit nga pronari, për një transferim nga një aktiv të kontrolluar nga pronari në një aktiv afatgjatë material të investuar; ose**
 - (d) **fillimi i një qiraje operative për një palë tjetër, për një transferim nga inventaret në aktivin afatgjatë material të investuar.**
 - (e) [e fshirë]

Data e hyrjes në fuqi

- 85B Janë ndryshuar paragrafët 8, 9, 48, 53, 54 dhe 57; paragrafi 22 është fshirë dhe janë shtuar paragrafët 53A dhe 53B me anë të *Përmirësimeve të SNRF-ve* të dala në maj të 2008-së. Një njësi ekonomike i zbaton këto ndryshime për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose pas 1 janarit 2009. Një njësi ekonomike lejohet të zbatojë ndryshimet për aktivet afatgjata materiale të investuara që janë në ndërtim nga data para 1 janarit 2009, me kusht që vlerat e drejta të aktiveve afatgjata materiale të investuara në ndërtim të përcaktohen në atë datë. Lejohet zbatimi i mëparshëm. Nëse një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt dhe do të zbatohet në të njëjtën kohë ndryshimet e paragrafit 5 dhe 81E të SNK 16 për Tokës, Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet.

Shtojcë për Ndryshimin e SNK 40

Ndryshimi i SNK 16

Njësitë ekonomike zbatojnë ndryshimin e SNK IAS 16 në këtë shtojcë kur zbatojnë ndryshimet e lidhura të SNK 40.

SNK 16 Toka, Ndërtesat, Makineritë dhe Pajisjet

Ndryshohet paragrafi 5. Shtohet paragrafi 81E.

- 5 Një njësi ekonomike që përdor metoden e kostos për aktivin afatgjatë material të investuar në përputhje me SNK 40 *Aktiv Afatgjatë Material i Investuar* do të përdorë metoden e kostos në këtë Standard.

Data e hyrjes në fuqi

- 81E U ndryshua paragrafi 5 me anë të *Përmirësime të SNRF-ve* të dala në maj 2008. Një njësi ekonomike i zbaton ndryshimet për periudha vjetore duke filluar që nga 1 janari 2009 ose pas 1 janarit 2009. Zbatimi i hershëm lejohet nëse një njësi ekonomike zbaton dhe ndryshimet e paragrafëve 8, 9, 22, 48, 53, 53A, 53B, 54, 57 dhe 85B të SNK 40 në të njëjtën kohë. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt.

Ndryshim në Standardin 41 të Kontabilitetit Ndërkombëtar : *Bujqësia*

Janë ndryshuar paragrafët 5, 6, 17, 20 dhe 21. Është shtuar paragrafi 60.

Përkufizime

Përkufizime të lidhura me bujqësinë

- 5 **Termet e mëposhtme në këtë Standard perdoren me këto kuptime specifike:**
- Aktivite bujqësor është menaxhimi nga një njësi ekonomike i transformimit biologjik dhe të korrrat e aktiveve biologjike për shitje ose konservim në prodhimin bujqësor ose një aktive shtesë biologjike.*
- ...
- 6 Aktiviteti bujqësor përmbledh një gamë të shumëllojshme aktivitetesh, si për shembull rritjen e kafshëve, pylltarinë, të mbjellat vjetore ose të vazhdueshme, kultivimin e pemëve ose të bimëve, frutikulturën, akuakulturën (duke përfshirë dhe rritjen e peshkut). Ekzistojnë disa tipare të përbashkëta brenda këtij diversiteti:
- (a) ...
- (c) *Matja e ndryshimit.* Ndryshimi në cilësi (për shembull merita gjenetike, densiteti, pesha, metrat kubë, gjatësia ose diametri i fibrës, numri i sythave) të shkaktuara nga transformimi biologjik ose të korrrat menaxhohen dhe monitorohen si një funksion rutinë menaxhimi.

Njohja dhe Matja

- 17 Nëse një treg aktiv ekziston për një aktiv biologjik ose një prodhim bujqësor në vendndodhjen dhe kushtin e tij aktual, çmimi i kuotuar në treg është baza përkatëse për përcaktimin e vlerës së drejtë të aktivit. Nëse një njësi ekonomike ka akses në tregje të ndryshme aktive, njësi ekonomike përdor aksesin më të përshtatshëm. Për shembull, nëse një njësi ekonomike ka akses në dy tregje aktive, ajo do të përdorte çmimin që ekzistonte në treg, i cili pritej që të përdorej.
- 20 Në disa rrethana çmimet ose vlerat e përcaktuara nga tregu mund të mos jenë të disponueshme për një aktiv biologjik në kushtin aktual. Në këto rrethana, një njësi ekonomike përdor vlerën aktuale të flukseve neto të mjeteve monetare nga aktivi i skontuar në një normë aktuale të përcaktuar nga tregu për përcaktimin e vlerës së drejtë.
- 21 Objektivi i përlllogaritjes së vlerës aktuale të flukseve neto të mjeteve monetare është përcaktimi i vlerës së drejtë të aktivit biologjik në vendndodhjen dhe kushtin aktual. Një njësi ekonomike e merr parasysh këtë gjë në përcaktimin e normës së skontuar që do të përdoret dhe në vlerësimin e flukseve neto të mjeteve monetare. Në përcaktimin e vlerës aktuale të flukseve neto të vlerës monetare që priten, një njësi ekonomike përfshin fluksin neto të mjeteve monetare që pjesëmarrësit e tregut presin që të gjenerojë aktivi në pjesën më të madhe të tregut përkatës.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha tranzitore

- 60 Paragrafët 5, 6, 17, 20 dhe 21 ndryshohen, dhe paragrafi 14 hiqet nga *Përmirësimet e FRSN-ve* të dala në maj 2008. . Një njësi ekonomike e zbaton atë ndryshim për periudha një vjeçare duke filluar më 1 janar 2009 ose pas datës 1 janar 2009. Lejohet aplikimi i mëparshëm. Nëse ndonjë njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë të mëparshme, ajo duhet ta bëjë me dije këtë fakt.

PJESA II

Ndryshimet në Pjesën II do të zbatohen për periudha vjetore që fillojnë më 1 janar 2009 ose pas 1 janarit 2009. Lejohet zbatimi i mëparshëm.

Ndryshim në Standardin 8 të Kontabilitetit Ndërkombëtar: *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Politikat Kontabël dhe Gabimet*

Ndryshohen paragrafët 7, 9 dhe 11.

Politikat kontabël

Përzgjedhja dhe zbatimi i politikave kontabël

- 7 Kur një SNK zbatohet në mënyrë specifike për një transaksion, për një aktivitet ose kusht tjetër, politika ose politikat kontabël që zbatohen në atë njësi do të përcaktohen duke zbatuar SNK-të.
- 9 SNK-të shoqërohen me udhëzime për t'u ardhur në ndihmë njësive ekonomike në zbatimin e kërkesave të tyre. Udhëzimet e tilla deklarohen nëse ajo është pjesë integrale e SNK-ve. Udhëzimi që është pjesë integrale e SNK-ve është i detyrueshëm. Udhëzimi që nuk është pjesë integrale e SNK-së nuk përfshin kërkesa për pasqyra financiare.
- 11 Në bërjen e gjykimit të përshkruar në paragrafin 10, njësia drejtuese do t'i referohet dhe do të shqyrtojë zbatueshmërinë e burimeve të mëposhtme në rend zbritës:
- (a) kërkesat e SNK-ve që merren me çështje të ngjashme ose të lidhura; dhe
 - (b) përkufizimet, kriteret e njohjes dhe konceptet për aktivet, pasivet, të ardhurat dhe shpenzimet në *Kuadër*.

Ndryshim në Standardin 10 të Kontabilitetit

Ndërkombëtar: *Ngjarjet pas Periudhës së Raportimit*

Ndryshohet paragrafi 13.

- 13 Nëse deklarohet dividenti (d.m.th. dividendët autorizohen siç duhet dhe nuk janë më në dorë të njësisë ekonomike) pas periudhës së raportimit, por para autorizimit të daljes së pasqyrave financiare, dividendët nuk njihen si pasiv në fund të periudhës së raportimit pasi në atë kohë nuk ekziston asnjë detyrim. Dividentë të tillë shpjegohen në shënime, në përputhje me SNK 1 *Paraqitja e pasqyrave Financiare*.

Ndryshim në Shtojcën e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 18 Të Ardhurat

Ndryshohet paragrafi 14(a) dhe shtohet një shënim në fund të faqes.

Ofrimi i shërbimeve

14 *Tarifa e shërbimit financiar.*

Njohja e të ardhurave për tarifa shërbimesh financiare varet nga qëllimi për të cilin janë vlerësuar tarifat dhe bazën e kontabilitetit për çdo instrument financiar të shoqëruar. Përshkrimi i tarifave për shërbime financiare mund të mos jetë tregues i natyrës dhe substancës së shërbimeve të ofruara. Si rezultat, është e nevojshme që të bëhet dallimi ndërmjet tarifave që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një instrumenti financiar, tarifat që prodhohen me ofrimin e shërbimeve, dhe tarifat që fitohen për ekzekutimin e një akti domethënës.

(a) *Tarifat që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një instrumenti financiar.*

Tarifa të tilla përgjithshme trajtohen si një rregullim i normës efektive të interesit. Gjithsesi, kur një instrument financiar matet në vlerën e drejtë me ndryshimin në vlerën e drejtë të njohurisë fitim ose humbje, tarifat njihen si të ardhura kur njihet fillimisht instrumenti.

(i) *Tarifat e origjinës nga njësia ekonomike të lidhura me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar të ndryshëm nga aktivi i dhënë në SNK 39 klasifikohet si aktiv financiar 'në vlerë të drejtë përmes përfitimi ose humbjes'.*

Tarifa të tilla mund të përfshijnë kompensim për aktivitete, si për shembull vlerësimi i kushteve financiare të huamarrësit, vlerësimi i garancive të regjistruara, kolaterale dhe rregullime të tjera të sigurisë, negocimin e kushteve të instrumentit, përgatitja dhe përpunimi i dokumenteve dhe mbyllja e transaksionit. Këto tarifa janë pjesë integrale e gjenerimit të përfshirjes me një instrument rezultues financiar, dhe, së bashku me kostot përkatëse të transaksionit * (siç përkufizohet në SNK 39), shtyhen dhe njihen si një rregullim i normës efektive të interesit.

(ii) *Tarifat e angazhimit të marra nga një njësi ekonomike për të filluar huamarrjen kur angazhimi për hua është jashtë objektit të SNK 39.*

Nëse është e mundur që njësia ekonomike të hyjë në një marrëdhënie specifike huadhënie, angazhimi për hua nuk është brenda objektit të SNK 39, tarifa e angazhimit konsiderohet si një kompensim për një përfshirje të vazhdueshme me blerjen e një instrumenti financiar dhe së bashku me kostot përkatëse të transaksionit (siç përcaktohet në SNK 39), shtyhet dhe njihet si një rregullim i normës efektive të interesit. Nëse angazhimi skadon pa njësinë ekonomike që bën huanë, tarifa njihet si e ardhur mbi skadimin. Angazhimet e huasë që janë brenda objektit të SNK 39 llogariten si derivative dhe maten në vlerën e drejtë.

(iii) *Tarifat e origjinës në daljen e aktiveve financiare të matura më koston e amortizimit.*

Këto tarifa janë pjesë integrale e një pjesëmarrje gjeneruese me një pasiv financiar. Kur një pasiv financiar nuk klasifikohet si 'më vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes', përfshihen tarifat e marra të origjinës me kostot përkatëse të transaksionit (siç përcaktohet në SNK 39), në shumën fillestare të mbartur të pasivit financiar dhe njihen si rregullim i normës efektive të interesit. Një njësi ekonomike bën dallimin e tarifave dhe të kostove që janë pjesë integrale e normave efektive të interesit për pasivin financiar nga tarifat e origjinës dhe kostot e transaksionit që lidhen me të drejtën për të ofruar shërbime, si për shembull shërbimet e menaxhimit të investimit.

* Në *Përmirësimet e SNK-ve* të dala në maj të 2008-ës, Bordi zëvendësoi termin 'kostot e drejtpërdrejta' me 'kosto transaksioni' siç përkufizohet në SNK 39. Ky ndryshim hoqi një mospërputhje kostosh që dilte në aktive dhe pasive financiare të origjinës që duhet të shtyhen dhe të njihen si një rregullim e normës efektive të interesit. 'Kostot e drejtpërdrejta', siç u përcaktuar më parë, nuk i lejonin kosto të tilla që të ishin rritëse.

Ndryshim në Standardin 20 të Kontabilitetit: *Kontabiliteti për Grantet qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Ndhmën Qeveritare*

Titulli i Standardit i shtohet një shënim mbi paragrafin 1, dhe ndryshohen paragrafët 2(b), 12–18, 20–22, 26, 27 dhe 32.

Shënimi për titullin

* Si pjesë e *Përmirësimeve të SNK-ve* të dala në maj të 2008, Bordi ndryshoi terminologjinë e përdorur në këtë Standard, në mënyrë që ajo të ishte në përputhje me SNK të tjera, si më poshtë:

- (a) ‘të ardhura të tatueshme’ u ndryshua në ‘fitim i tatueshëm ose humbje nga tatimi’,
- (b) ‘e njohur si e ardhur/shpenzim’ u ndryshua në ‘e njohur në fitim ose humbje’,
- (c) ‘që i jepet drejtpërsëdrejti interesave/kapitalit neto të aksionerëve’ u ndryshua në ‘fitim ose humbje e jashtme e njohur’, dhe
- (d) ‘rishikim i një vlerësimi kontabiliteti’ u ndryshua në ‘ndryshim në vlerësimin e kontabilitetit’.

Objekti

2 Ky Standard nuk trajton:

- (a) problemet e veçanta ... natyrën e njëjtë.
- (b) ndihmën qeveritare që i ofrohet një njësie ekonomike në formën e përfitimeve që janë disponueshme në përcaktimin e humbjes ose fitimit të taksueshëm, ose janë përcaktuar ose janë të kufizuar në bazën e pasivit të tatimit të të ardhurave. Shembuj të përfitimeve të tilla janë tatimi i të ardhurave të pushimeve, kredite të tatimit të investimeve, vlera të amortizimit të përshpejtuar dhe norma tatimi të ardhurash të zbritura.
- (c) qeveria ... subjekti ekonomik.
- (d) ...

Grantet qeveritare

12 Grantet e qeverisë do të njihen në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike gjatë periudhave në të cilat njësitë ekonomike njih si shpenzime kostot e lidhura të cilat synohet të kompensojnë grantet.

13 Ka dy qasje të gjera për kontabilitetin e granteve qeveritare: qasja kapitale, sipas së cilën një grant njihet jashtë fitimit ose humbjes, dhe qasja e të ardhurave, sipas së cilës një grant njihet në fitim ose humbje mbi një ose më shumë periudha.

14 Ata që janë pro qasjes kapitale argumentojnë si më poshtë:

- (a) Grantet qeveritare janë një instrument financimi dhe duhet të trajtohen si të tilla në pozicionin në pasqyrat financiare dhe jo të njihen si fitime ose humbje për të kompensuar zërat e shpenzimeve që financojnë ata. Për shkak të faktit se nuk njihet asnjë ripagesë, grante të tilla duhet të njihen jashtë fitimit ose humbjes.

- (b) nuk është e përshtatshme që të njihen grantet qeveritare në fitim ose humbje, sepse ato nuk fitohen, por përfaqësojnë një stimul që jepet nga qeveria pa kosto përkatëse.
- 15 Argumentet në mbështetje të qasjes së të ardhurave janë si më poshtë:
- (a) për shkak të faktit që grantet e qeverisë janë fatura nga një burim i ndryshëm nga aktorët, ato nuk duhet të njihen në mënyrë të drejtpërdrejtë në kapital neto, por duhet të njihen në fitim ose humbje në periudhat përkatëse.
- (b) grantet qeveritare rrallë jepen ka shkak. Njësia ekonomike i fiton ato nëpërmjet përputhjes me kushtet dhe detyrimet përkatëse. Si rezultat, ato duhet të njihen në fitim ose humbje në periudhat në të cilat njësia ekonomike njih si shpenzime kostot e lidhura të cilat synon të kompensojë granti.
- (c) për shkak të faktit se të ardhurat dhe tatimet e tjera janë shpenzime, është logjike që të merremi dhe me grantet qeveritare, që përbëjnë shtrirje të politikave fiskale, në përfitime ose humbje.
- 16 Është thelbësore për qasjen e të ardhurave që grantet e qeverisë të njihen si përfitime ose humbje në një bazë sistematike gjatë kohës në të cilën njësia ekonomike njih si shpenzime kostot e lidhura që synohet të kompensojë granti. Njohja e granteve qeveritare në fitime ose humbje mbi bazën e faturave nuk është në përputhje me supozimin e kontabilitetit të drejtave të detyrimeve të konstatuara (shih SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*) dhe do të jetë e pranueshme vetëm nëse nuk ekziston asnjë bazë për alokimin e granteve në periudha të ndryshme nga periudha e marrjes.
- 17 Në pjesën më të madhe të rasteve, periudhat në të cilat një njësi ekonomike njih kostot ose shpenzimet e lidhura me një grant qeveritar janë gati të përcaktueshme. Pas njohjes së shpenzimeve specifike, këto grante njihen në përfitime ose humbje në të njëjtën periudhë si shpenzimet përkatëse. Në të njëjtën mënyrë, grantet e lidhura me aktivet e amortizuara përgjithësisht njihen në fitim ose humbje gjatë periudhave dhe në përpjesëtim me shpenzime e amortizimit të njohura për ato aktive.
- 18 Grantet e lidhura me aktivet e pa-amortizuara mund të kërkojnë gjithashtu plotësimin e disa detyrimeve të caktuara dhe më pas do të njihen në fitim ose humbje gjatë periudhave që mbartin koston e plotësimit të detyrimeve. Si shembull, një grant toke mund të ketë kushtëzues ndaj ngritjes së një ndërtese në një terren dhe mund të jetë e drejtë që të njihet granti në përfitim ose humbje gjatë jetës së ndërtesës.
- 20 Një grant qeveritar që merret si kompensim për shpenzimet ose humbjet e pësuar ose për qëllim e dhënies së një mbështetje të menjëhershme financiare për njësinë ekonomike pa kosto të lidhura me të ardhmen, do të njihet në fitim ose humbje të periudhës në të cilën jepet ajo.**
- 21 Në disa rrethana, një grant qeveritar mund të jepet për qëllim të dhënies së mbështetjes financiare të menjëhershme për të mbështetur një njësia ekonomike dhe ato si stimul për të bërë shpenzime specifike. Grante të tilla mund të jenë të kufizuara për një njësi të caktuar ekonomike dhe mund të mos jenë të disponueshme për të gjithë klasën e përfituesve. Këto rrethana mund të kërkojnë njohjen e një granti në fitim ose humbje në periudhën në të cilën njësia ekonomike kualifikohet për ta marrë atë, me dhënien e informacionit shpjegues për t'u siguruar se efekti i tij është kuptuar qartë.
- 22 Një grant qeveritar mund të merret nga një njësi ekonomike si kompensim për shpenzimet ose humbjet e një periudhe të mëparshme. Një grant i tillë njihet në fitim ose humbje të periudhës në të cilën ai merret, me dhënien e informacionit shpjegues për t'u siguruar se efekti i tij është kuptuar qartë.

Dhënia e granteve të lidhura me aktivet

- 26 Një metodë e njeh grantin si një e ardhur e shtyrë që llogaritet në fitim ose humbje mbi një bazë sistematike përgjatë jetës së dobishme të aktivit.
- 27 Metoda tjetër zbrit grantin në përlogaritjen e shumës mbartëse të aktivit. Granti njihet në fitim ose humbje gjatë jetës së një aktivi të amortizueshëm si një shpenzim i ulur amortizimi.

Repagimi i granteve qeveritare

32

Një grant qeveritar që bëhet i ripagueshëm do të llogaritet si një ndryshim në vlerësimin e kontabilitetit (shih SNK 8 *Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësime dhe Gabimet*). Ripagimi i një granti të lidhur me të adhurat do të zbatohet së pari kundrejt çdo krediti të shtyrë e të paamortizuar në lidhje me grantin. Deri në masën që ripagesa e tejkalon çdo kredit të tillë të shtyrë, ose kur nuk ekziston asnjë kredit i shtyrë, pagesa do të njihet përnjëherë në fitim ose humbje. Ripagimi i një granti të lidhur me një aktiv do të njihet me anë të rritjes së shumës mbartëse të aktivit ose uljes së bilancit të të ardhurave të shtyra që do të ishin njohur në fitimin ose humbjen deri më sot në mungesë të grantit dhe do të njihen menjëherë në fitim ose humbje.

Shtojcë në Ndryshimin e SNK 20

Ndryshimeve të SNK 41

Njësitë ekonomike zbatojnë ndryshimet e SNK 41 në këtë Shtojcë kur aplikojnë ndryshimet përkatëse në terminologjinë e përdorur në SNK 20.

SNK 41 Bujqësia

Ndryshohen paragrafët 34–36.

Grantet qeveritare

- 34 Një grant qeveritar i pakushtëzuar i lidhur me një aktiv biologjik të matur në vlerën e tij të drejtë heq koston e shitjes do të njihet si fitim ose humbje kur, dhe vetëm kur merret granti qeveritar.
- 35 Nëse një grant qeveritar që lidhet me një aktiv biologjik të matur në vlerën e tij të drejtë minus koston e shitjes është kushtëzues, duke përfshirë dhe kur një grant qeveritar kërkon që një njësi ekonomike të mos angazhohet në një aktivitete specifike bujqësore, njësi ekonomike njih grantin qeveritar në fitim ose humbje, kur, dhe vetëm kur janë plotësuar kushtet që kërkohen për një grant qeveritar.
- 36 Afatet dhe kushtet e granteve qeveritare janë të ndryshme. Për shembull, marrja e një granti mund t'i kërkojë një njësi ekonomike të qëndrojë në një vend të caktuar për pesë vjet, dhe t'i kërkojë njësisë ekonomike që të kthejë të gjithë grantin nëse ajo qëndron në të njëjtin vend për një periudhë më të shkurtër sesa pesë vjet. Në këtë rast granti nuk njihet në fitim ose humbje deri sa të kenë kaluar të pesë vjetët. Gjithsesi, nëse kushtet e grantit e lejojnë një pjesë të tij të merret në përputhje me kohën që ka kaluar, njësi ekonomike e njih atë pjesë në fitim ose humbje ndërkohë që kalon koha.

Ndryshim në Standardin 29 të Kontabilitetit Ndërkombëtar: *Raportimi Financiar në Ekonomitë Hiperinflacionare*

Titulli të Standardit, paragrafi 1, i shtohet një shënim, dhe ndryshojnë paragrafët 8, 14, 20, 28 dhe 34.

Shënim për titullin

* Si pjesë e *Përmirësimeve të SNK-ve* të dala në maj të 2008-ës, Bordi i ndryshoi termat e përdorura në SNK 29 në mënyrë që ato të ishin në përputhje me SNK si më poshtë: (a) 'vlera e tregut' ndryshohet në 'vlera e drejtë', dhe (b) 'rezultatet e operacioneve' dhe 'të ardhurat neto' ndryshohen si 'fitim ose humbje'.

Riparaqitja e pasqyrave financiare

- 8 Pasqyrat financiare të një njësie ekonomike monedha funksionale e të cilës është monedha e ekonomisë hiperinflacioniste, pavarësisht nëse bazohen në qasjen e kostos historike apo në qasjen e kostos aktuale, do të deklarohen për sa i përket monedhës së njësisë matëse në fund të periudhës së raportimit. Shifrat korresponduese për periudhën e mëparshme që kërkohen nga SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare* (siç rishikohet në 2007) dhe çdo informacion në lidhje me periudhat e mëparshme do të paraqitet në kushtet e njësisë matëse aktuale në fund të periudhës së raportimit. Për arsye të paraqitjes së shumave krahasuese në monedha të ndryshme paraqitje, zbatohen paragrafët 42(b) dhe 43 të SNK 21 *Efektet e Ndryshimeve në Kurset e Monedhës së Huaj*.

Pasqyrat financiare të kostove historike

Pasqyra e pozicionit financiar

- 14 Të gjitha aktivet dhe pasivet janë jomonetare. Disa artikuj jomonetarë mbarten në shuma aktuale në fund të periudhës së raportimit, si për shembull vlera e realizuar neto dhe vlera e drejtë, në mënyrë që ato të mos riparaqiten. Të gjitha aktivet dhe pasivet e tjera jo-monetare riparaqiten.
- 20 Një i investuar llogaria e të cilit bëhet me atë të metodës së kapitalit neto mund të raportojë në monedhën e ekonomisë hiperinflacioniste. Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave të kuptueshme të një të investuari të tillë riparaqiten në përputhje me këtë Standard në mënyrë që të llogaritet aksioni i investuesit për aktivet e tij neto dhe fitimi apo humbja. Kur pasqyrat financiare të riparaqitura të një të investuari shprehen në monedhë të huaj, ato përkthehen në norma/ kurse përmblyëse.

Fitimi ose humbja e pozicionit monetar neto

- 28 Fitimi ose humbja e pozicionit monetar neto përfshihet në fitimin ose humbjen. Rregullimi i këtyre aktiveve ose pasiveve të lidhura me marrëveshje me ndryshimet në çmime, të bëra në përputhje me paragrafin 13, është kompensim kundrejt përfitimit ose humbjes në pozicionin monetar neto. Element të tjera të të ardhurave ose të shpenzimeve, si për shembull të ardhurat e interesit dhe shpenzimet, dhe diferencat e kursit të këmbimit të lidhura me fonde të investuara ose të marra hua, lidhen gjithashtu me pozicionin monetar neto. Megjithëse elementë të tillë shpjegohen veçmas, mund të jetë me dobi që ata të paraqiten së bashku me përfitimin ose humbjen në pozicionin monetar neto në deklaratën e të ardhurave të kuptueshme.

Shifrat korresponduese

- 34 Shifrat korresponduese për periudhat e mëparshme të raportimit, pavarësisht nëse bazoheshin në qasjen e kostos historike apo në qasjen e kostos aktuale rideklarohen duke aplikuar një indeks të përgjithshëm çmimi në mënyrë që pasqyrat financiare të krahasueshme paraqiten për sa i përket

njësise matëse që ekziston në fund të periudhës së raportimit. Informacioni që jepet në lidhje me periudha të mëparshme shprehet gjithashtu në lidhje me njësinë matëse të pranishme në fund të periudhës së raportimit. Për qëllim të paraqitjes së shumave krahasuese në monedha të ndryshme paraqitje, zbatohen paragrafët 42(b) dhe 43 të SNK 21.

Ndryshim në Standardin 34 të Kontabilitetit

Ndërkombëtar: *Raportimi Financiar i Përkohshëm*

Ndryshohet paragrafi 11 dhe shtohet një shënim.

Forma dhe përmbajtja e pasqyrave financiare të përkohshme

- 11 Në pasqyrën që përfaqëson komponentët e fitimit dhe të humbjes për një periudhë të përkohshme, një njësi ekonomike paraqet fitime bazë dhe të pakësuara për aksionin e asaj periudhe kur njësia ekonomike është brenda objektit të SNK 33 *Fitimet për Aksion*.*

* Ky paragraf u ndryshua me anë të *Përmirësimeve të SNK-ve* të dala në maj 2008 për të qartësuar objektin e SNK 34.

Ndryshim në Standardin 40 të Kontabilitetit

Ndërkombëtar: *Aktiv Afatgjatë Material i Investuar*

Masat pas njohjes

Politika e kontabilitetit

- 31 SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet* thotë që një ndryshim vullnetar në politikën kontabël bëhet vetëm nëse ndryshimi çon në pasqyra financiare që japin informacion më të besueshëm dhe më të përshtatshëm rreth efekteve të transaksionit, aktiviteteve ose kushteve të tjera për pozicionin financiar të njësisë ekonomike, performancës financiare ose flukseve të mjeteve financiare. Ka shumë pak të ngjarë që një ndryshim nga një model i vlerës së drejtë të çojë në një paraqitje më të mirë.

Modeli i vlerës së drejtë

- 50 Në përcaktimin e shumës mbartëse të aktivitet afatgjatë material të investuar në modelin e vlerës së drejtë, një njësi ekonomike nuk numëron dy herë aktivet dhe pasivet që njihen si aktive ose pasive të veçanta. Për shembull:
- (a) ...
 - (d) vlera e drejtë e aktivitet afatgjatë material të investuar nën një qira reflekton fluks të pritur të mjeteve monetare (duke përfshirë qiranë që pritet të bëhet e pagueshme). Si rezultat, nëse një vlerësim i marrë për një pronë është netoja e të gjitha pagesave që pritet të bëhen, do të jetë e nevojshme që të shtohet çdo pasiv i njohur qiraje për të arritur në shumën mbartëse të aktivitet afatgjatë material të investuar duke përdorur modelin e vlerës së drejtë.

Ndryshim në Standardin 41 të Kontabilitetit

Ndërkombëtar: *Bujqësia*

Hiqet paragrafi 14. Termat ‘kosto të vlerësuar të pikës së shitjes’ dhe ‘kosto të pikës së shitjes’ zëvendësohen me ‘kosto për të shitur’ kur dalin në vendet e mëposhtme:

- Standardi (paragrafët 12, 13, 26–28, 30–32, 34, 35, 38, 40, 48, 50 dhe 51)

Objekti

- 4 Tabela më poshtë përmban shembuj të aktiveve biologjike, prodhimeve bujqësore dhe produkteve që merren pas të korrave:

Aktive biologjike	Prodhime bujqësore	Produkte që merren/përtohen pas të korrave
...		
Pemët ne pyll	Pemët e prera	Trungjet/lëndët drusore
...		

Përkufizime

Përkufizime të lidhura me bujqësinë

- 5 Termat e mëposhtme përdoren në këtë Standard me këto kuptime:

...

Kostot e shitjes janë kosto rritëse që lidhen drejtpërdrejt me nxjerrjen jashtë përdorimit të një aktivi, duke përjashtuar kostot financiare dhe tatimin mbi të ardhurat.

...

Njohja dhe Matja

Shtojcë për Ndryshimet në SNK 41 Ndryshimet në SNK të tjera

Njësitë ekonomike i zbatojnë këto ndryshime në SNK 5 Aktive Jofinanciare të Mbajtura për Shitje dhe Veprime të Ndërprera, Inventarët e SNK 2, dhe SNK 36 Shvlerëimi i Aktiveve kur ato zbatojnë ndryshimet e lidhura me SNK 41.

ANRK 5 Aktivët Jofinanciare të mbajtura për shitje dhe Veprime të Ndërprera

Paragrafi 5 ndryshohet.

Objekti

- 5 Dispozitat e matjes së kësaj SNK* nuk zbatohen për aktivet e mëposhtme, të cilat mbulohen nga SNK-të e dhëna në listë, si aktive individuale ose si pjesë e grupit të daljes jashtë përdorimi:
- (a) ...
 - (e) aktivet jofinanciare që janë matur në vlerën e drejtë pa kostot e shitjes, sipas SNK 41 *Bujqësia*.
 - (f) ...
- * Të ndryshme nga paragrafët 18 dhe 19 që kërkojnë që aktivet në fjalë të maten në përputhje me SNK të tjera të zbatueshme.

IAS 2 Inventarët

Ndryshohet paragrafi 20.

- 20 Në përputhje me SNK 41 *Bujqësia* inventarët që përfshijnë prodhimet bujqësore që ka prodhuara një njësi ekonomike nga aktivet e saj biologjike maten me njohjen fillestare në vlerën e drejtë pa kostot e shitjes për t'u shitur në pikën e të korrurave. Kjo është kostoja e inventareve në datën e zbatimit të këtij Standardi.

IAS 36 Çvlerësimi i Aktiveve

Ndryshohen paragrafët 2 dhe 5.

Objekti

- 2 Ky Standard zbatohet në kontabilitet për çvlerësimin e të gjitha aktiveve, të ndryshme nga:
- (a) ...
 - (g) aktivet biologjike të lidhura me një aktivitet bujqësor që maten në vlerën e drejtë pa kostot e shitjes (shih SNK 41 *Bujqësia*);
 - (h) ...
- 5 Ky Standard nuk zbatohet për aktivet financiare brenda objektit të SNK 39, aktivi afatgjatë material i investuar në vlerën e drejtë në përputhje me SNK 40, ose të matur në vlerën e drejtë pa

kostot e shitjes në përputhje me SNK 41. Gjithsesi, ky Standard zbatohet për aktive që mbarten në shumë të rivlerësuar (p.sh. vlera e drejtë) në përputhje me SNK të tjera, si për shembull model i rivlerësimit në SNK 16 *Toka, Ndërtesat, Makinerive dhe Pajisjeve*. Identifikimi nëse një aktiv i rivlerësuar çvlerësohet varet nga baza për të përcaktuar një vlerë të drejtë:

(a) ...